



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr \_\_\_\_ Prot

Elbasan ,më \_\_. \_\_.2023

**Lënda : Kthim përgjigje**

Ne vijim të shkreses tuaj ardhur prane institucionit tone me Nr. **4849** prot date **02/10/2023** "Kërkesë për informacion" po ju dergojme informacionin si më poshtë :

Në lidhje me kërkesën për dy objektet arsimore **Jonuz Çarçiu** dhe **Naim Frasheri** nga zyra e projekteve të Bashkisë Elbasan janë hartuar projektet me vlerat e investimit **128 036 545** leke për shkollën **Jonuz Çarçiu** dhe **254 546 123** lek per shkollën **Naim Frashëri** dhe kostoja e projektimit është 0 për shkak se është projektuar nga stafi I Bashkisë Elbasan . Të dyja projektet për të tretin vit rradhazi janë aplikuar për financim nga buxheti I shtetit .Për shkak të kostos së lartë të preventivit janë të pamundura për tu financuar nga buxheti I Bashkisë Elbasan . Jemi në pritje të miratimit të këtyre projekteve .

- Referuar pikes Nr .1 tuajes ku kerkohet në çfare faze është procesi i rindertimit te shkollës "**Jonuz Carciu** , po ju informojme **se punimet ende nuk kane filluar si pasoje e mospasjes së financimit për këtë shkolle pasi është aplikuar shume here për fonde dhe ende nuk është financuar.**

- Referuar pikes Nr 2 per numrin e nxënësve që mësojnë në këtë shkollë bazuar informacioneve te para 3-viteve kur është hartuar dhe projekti behej fjale per rreth 240 nxënës.

Referuar pikes Nr 5 në bazë të informacioneve te para 1-viti kur eshte hartuar dhe projekti behej fjale per rreth 720 nxenes.

- Referuar pyetjes Nr.12 ku kerkohet se në çfare faze janë punimet **për rrugen e Funarit po ju informojme se punimet ende nuk kane filluar.**

Projekti është hartuar nga bashkia e Elbasanit dhe I është dhuruar Këshillit të Qarkut bazuar në një marrveshje bashkëpunimi , ku investitor do të jetë Këshilli Qarkut . Ky projekt **do të filloj zbatimin me përfundimin e procedurës së prokurimit e cila ka filluar .**

- Referuar pyetjes Nr.13 ku kerkohet vlere investimit po ju informojme se segmenti i cili pritet te financohet nga Letani - Bixellenje kushton 38 064 034 leke, sigurisht qe kemi preventivin perkates.

- Referuar pyetjes Nr.14 ku kerkohet koha e fillimit po ju informojme se pritet t fillojne sapo te mbarojne procedurat e prokurimit, te cilat pritet te fillojne se shpejti.

- Referuar pyetjes Nr.15 ku kerkohet koha njesia zbatuese , ky projekt pritet te financohet me fondet e Keshillit Qarkut Elbasan.

Referuar pikës Nr. 16 ,ku thuhet se: Në cilën fazë janë punimet për pastrimin dhe sistemimn e **përroit të "Gurrës" Shushicë** , ju bejmë me dije se :

Përroi I Gurrës kalon në mes të fshatit Shushicë, është një përrua shunë I rrezikshëm ,pasi gjatë periudhës së dimrit nga prurjet e teperta , del nga shtrati i tij dhe përmyt gjithë fushën e Shushicës. Duke qënë se ka një pjerrësi shumë të madhe, sjell material inverte dhe e mbush menjëherë përroin. **Investimi I fundit është bërë në janar të vitit 2022 nga mjetet e ASHP.**

Eshtë pastruar materiali dhe është hedhur në argjinaturë duke krijuar trashje të saj me volum 3250 m<sup>3</sup>.

Eshtë pastruar 900 ml nga Ndërmarrja ASHP me mjetet e saj **dhe nuk ka patur investime të tjera.**

Pastrimi që ne I kemi bere fillon tek ura e hekurit deri ne bërryl dhe në zonën ku përroi del nga shtrati. Ndersa përsa I përket **informacionit për pikat 7-11** ju sqarojme si më poshtë :

Bashkia Elbasan disponon 16629 ha.toke bujqesore nga te cilat 4900 ha toke i ka te mbjella me pemtari, vreshte, ullinj etj.

Nga totali i siperfaqes te pemëtarise 2200 ha jane ullinj, vreshte 370 ha,geshtenja 380 ha, qershia 280 ha, pjeshka 250 ha, kumbulla 260 ha, dardha 100 ha,molle 170 ha, kajsi 60 ha etj Bujqesia eshte e zhvilluar ne te 12 njesite administrative, por perparesi e zhvillim te mire kane 6 njesite administrative fushore qe disponojne 7800 ha toke bujqesore ne fushe.

**Aktualisht Bashkia Elbasan ka 10 pika te grumbullimit te produkteve bujqesore dhe bimeve medicinale**

Zhvillimi i bujqesise kerkon akoma mbeshtetje, investime e financime dhe per ti ardhur ne ndihme fermerëve per shtimin e prodhimit bujqesor me keto propozime si me poshte:

#### .Pika grumbullimi.

**a- Është menduar që të ngrihet nje pike grumbullimi për frutat në njësinë administrative Shushicë në vëndin e quajtur ish qendra e rezervave të Shtetit.**

Në kete pike do te grumbullohen fruta te gjithë llojeve për të 6 njesite administrative te zones “Shpatit” me perspektive per te ndertuar edhe nje pike te perpunimit te frutave.

Tendenca e ketyre prodhimeve eshte ne rritje dhe siperfaqja vazhdon te shtohet nga viti në vit.

Sot në këto 6 njësi administrative Shirgjan,Shushicë,Gjergjan,Tregan,Gjinar e Zavalinë kemi nje sipërfaqe me pemë frutore afro 1000 ha ose 250.000 rrënje dhe prodhohen 3500 ton fruta për të cilën fermeret kanë nevojë për grumbullimin e prodhimeve ,gjetjen e tregut ose përpunimin e tyre. Kjo pikë do grumbullojë kumbulla,mollë,fiq, kajsi, hurma, rrush, arra etj.

**b- Pike grumbullimi të frutave si: pjeshke, dardha, geshtenja ne njesine administrative Bradashesh** per 6 njesite administrative mbi lumin Shkumbin si : njësia Paper Bradashesh,Gracen, Funar, Labinot-Fushe e Labinot Mal, ku sot kultivojne nje siperfaqe prej 120 ha pjeshka ose 50000 rrenje me prodhim vjetor 1900 ton.

Kjo kulture për vete cmimet e tregut dhe kushtet klimatike ka nje rritje vjetore prej 10-15% te siperfaqes.

Dardha disponojme 22000 rrenje dhe prodhohet 480 ton ne vit,kumbulla kemi 60600 rrenje me prodhim vjetor 1100 ton

Geshtenja eshte nje frut tjetër ku dallohet njesia administrative Labinot-Mal dhe kultivojme 94000 rrenje me nje prodhim mesatar vjetor 1400-1600 ton

**c- Pike grumbullimi te ullirit dhe qershisë në njësinë administrative Gjergjan** meqenëse .qershia kultivohet më shumë në njësinë administrative Labinot-Fushe,Shirgjan, Tregan, Gjinar, Labinoti Mal etj që jane zona tipike për qershinë dhe gjithsej kemi 70.000.rrënjë qershia me një prodhim mesatar vjetor 1500 ton e cila për vete vecorite specifike që ka ky frut i cili nuk reziston gjate e kerkon nje evadim te shpejte te prodhimit dhe pika e grumbullimit per kete produkt eshte domosdoshmeri

Gjithshtu Bashkia ka 650.000 rrenje ullinj me një prodhim vjetor 8000 ton me perspektive rritje 10% per cdo vit pasi shtohet numri i rrënjëve në prodhim.

Elbasani si zone tipike historike e rritjes ullirit per vete kushtet klimatike ka nje prodhimtari te larte te kesaj kulture ku pikat e grumbullimit duhet te luajne rol te rëndesishen per fermeret te cilet kane shume probleme me gjetjen e tregjeve .